



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË



DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

THIRRJE PËR APLIKIM

I. Përkrahje në blegtori-pagesa direkte

Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Fushë Kosovës, të cilët posedojnë gjedhe qumështore dhe kafshë të imëta-dele dhe dhi, se mund të aplikojnë për pagesa direkte(subvencione) në lëmin e blegtorisë.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

Përkrahen fermerët që kanë:

- 3-20 krerë gjedhe (lopë qumështore)
- 20-150 krerë dele
- 20-150 dhi
- Kafshët duhet të jenë të matriculuara;
- Përfituesi duhet të jetë banorë i Komunës së Fushë Kosovës
- Objekti (stalla) duhet të jetë në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues të vlefshëm të Republikës së Kosovës
- Konfirmimi i llogarisë bankare 2025;
- Vërtetim nga shërbimet veterinarë;
- Numri identifikues i fermerit (NIF)
- Lista e matriculimit të kafshëve.

Komuna Fushë Kosovë-Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Adresa: Rr. "Tahir Zemaj", Nr : 2, Fushë Kosovë - 12000 Kosovë

<http://kk.rks-gov.net/fushekosove>



DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

II. Përkrahje në bletari – pagesa direkte

Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Fushë Kosovës, të cilët posedojnë bletë, se mund të aplikojnë për pagesa direkte (subvencione) në lëmin e bletarisë.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Përkrahen bletarët që kanë 5 – 29 shoqëri bletësh;
- Bletarët duhet t'i kenë të vendosura bletët vetëm në një bletore;
- Përfituesi duhet të jetë banorë rezident i Komunës së Fushë Kosovës dhe të ketë bletoren në territorin e Komunës së Fushë Kosovës;
- Përfituesi – bletarët duhet të kenë të shenjëzuar kosheret (shtëpizat e bletëve);
- Numri identifikues i fermerit (NIF) duhet të jetë i vendosur në shabllon, në përmasat 30 x 12 cm, në trupin e kosheres, jo në kapak, i shënuar me ngjyrë të përhershme.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi i llogarisë bankare 2025;
- Numri identifikues i fermerit (NIF).



DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

III. Përkrahje në shpezëtari-pagesa direkte

Ftohen të gjithë fermerët (person juridik) e fermave komerciale që posedojnë pula vojse dhe zogj për majmëri në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, se mund të aplikojnë për pagesa direkte (subvencione) në lëmin e shpezëtarisë.

Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Aplikuesi duhet të ketë fermën (objektin) në territorin e Komunës së Fushë-Kosovë dhe të jetë banorë i tij;
- Përfitues mund të jenë fermerët (person juridik) e fermave që kanë 300 deri 3000 copë pula vojse dhe zogj për majmëri (brojler);
- Ferma duhet të jetë e regjistruar.

Dokumentacioni i nevojshëm

- Kopja e certifikatës së biznesit;
- Certifikata e numrit fiskal
- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar (përfaqësues i biznesit);
- Konfirmimi i llogarisë bankare 2025 ;
- Dëshmi për numrin dhe origjinën e pulave vojse dhe zogjve për majmëri (faturën);
- Dëshmi mbi gjendjen shëndetësore të pulave të lëshuar nga autoriteti kompetent (AUVK).

Data për aplikim prej 12.05.2025 deri më 30.05.2025, aplikimi bëhet në të gjitha sportelet e Qendrës për Shërbime me Qytetar.

VËREJTJE

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar që t'i sjellë ato në afatin i cili i caktohet, në të kundërtën humb të drejtën për të qenë përfituesi i subvencionit.

Drejtorë e Drejtorisë
së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

